

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikadur®-30

ADEZIV EPOKSID TIKSOTROPIK PËR NGJITJE TË PËRFORCIMIT



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikadur®-30 është ngjitës tiksotropik, strukturor, me 2 përbërës, bazë kombinimi rrëshirash epokside dhe lëndësh mbushëse (fillers) të posaçme, për përdorim në temperatura normale midis +8°C dhe +35°C.

PËRDORIMET

Sikadur®-30 duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë. Ngjitës për armaturën e jashtme përforcuese, veçanërisht në punimet e përforcimeve strukturore ku përfshihen:

- Petëzat Sika CarboDur® në beton, tulla dhe dru (për detaje shih skedën teknike Sika CarboDur®, "Method Statement Përforcimi Sika CarboDur® me ngjitje të jashtme" Ref: 850 41 05 & "Method Statement Përforcimi Sika CarboDur® i montuar pranë sipërfaqes" Ref: 850 41 07).
- Petëza çeliku në beton (për detaje shih Informacionin Teknik përkatës Sika).

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

Sikadur®-30 ka avantazhet e mëposhtme:

- Përzierje dhe aplikim i lehtë
- Nuk nevojitet prajmer
- Rezistencë e lartë ndaj zvarrjes në ngarkesë të përhershme
- Ndërkapje shumë e mirë mbi beton, mur, gur, çelik, gize, alumin, dru dhe pllakat Sika CarboDur®.
- Ngurtësimi nuk ndikohet nga lagështia e lartë
- Ngjitës i fuqishëm
- Tiksotropik: nuk varet në aplikime vertikale
- Fortësohet pa turrje
- Përbërës me ngjyra të ndryshme (për kontroll të përzierjes).
- Rezistencë mekanike fillestare & përfundimtare e lartë
- Rezistencë e lartë ndaj abrazionit & shokut
- I padepërtueshëm nga lëngjet dhe avujt e ujit

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- Pajtohet me LEED v4 MRc 4 (Opsioni 2): Njohja & optimizimi i produktit të ndërtimit - përbërësit e materialit
- Pajtohet me LEED v2009 IEQc 4.1: Materiale me çlirime të ulëta - adezivë & izolues

MIRATIME / STANDARDE

- IBMB, TU Braunschweig, Raport testimi nr. 1871/0054, 1994: Miratimi për adezivin epoksid Sikadur®-30.
- IBMB, TU Braunschweig, Raport testimi nr. 1734/6434, 1995: Testim për llaçin Sikadur®-41 Epoxy i kombinuar me adezivin epoksid Sikadur®-30 për ngjitjen e pllakave prej çeliku.
- Avis Technique N° 3/16-875 (annule et remplace N° 3/10-669) Sika® CarboDur®, SikaWrap®
- CIT n°290 18/07/2017 (certificato di idoneità tecnica all'impiego) ; Sika® CarboDur®, SikaWrap®, Sikadur®
- Adeziv për ngjitje strukturore testuar sipas EN 1504-4, mbart markën CE

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Rrëshirë epokside	
Ambalazhi	6 kg (A+B)	njësi e parapaketuar paletë 480 kg (80 x 6 kg)
	Ambalazh industrial (paletë me 14 kova):	
	Përbërësi A	kovë 30 kg
	Përbërësi B	kovë 10 kg
Ngjyra	Përbërësi A: i bardhë Përbërësi B: i zi Përbërësit A+B të përzierë: gri e lehtë	
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.	
Dendësia	1.65 kg/l ±0.1 kg/l (përbërësit A+B të përzierë) (në +23 °C)	

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes		(EN 196)	
		+10 °C	+35 °C		
	12 orë	-	~85 N/mm ²		
	1 ditë	~55 N/mm ²	~90 N/mm ²		
	3 ditë	~70 N/mm ²	~90 N/mm ²		
	7 ditë	~75 N/mm ²	~90 N/mm ²		
Moduli i elasticitetit në ngjeshje	~9 600 N/mm ² (në 23 °C)			(ASTM D 695)	
Rezistenca ndaj tërheqjes	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes		(DIN EN ISO 527-3)	
		+15 °C	+35 °C		
	1 ditë	~20 N/mm ²	~26 N/mm ²		
	3 ditë	~23 N/mm ²	~27 N/mm ²		
	7 ditë	~26 N/mm ²	~29 N/mm ²		
Moduli i elasticitetit në tërheqje	~11 200 N/mm ² (+23 °C)			(ISO 527)	
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	Koha e tharjes	Nënshtresa	Temp. e tharjes	Rezistenca e ndërkapjes	(EN ISO 4624, EN 1542, EN 12188)
	7 ditë	Beton i thatë	+23°C	> 4 N/mm ² *	
	7 ditë	Çelik	+23°C	>21 N/mm ²	
*100% dështim betoni					
Rezistenca ndaj prerjes	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes		(FIP 5.15)	
		+15 °C	+23 °C		+35 °C
	1 ditë	~4 N/mm ²	-		~17 N/mm ²
	3 ditë	~15 N/mm ²	-		~18 N/mm ²
	7 ditë	~16 N/mm ²	18 N/mm ² (1)		~18 N/mm ²
Dështim betoni (~15 N/mm ²) (1) (DIN EN ISO 4624)					
Tkurrja	0.04 %		(FIP: Fédération Internationale de la Précontrainte)		
Koeficienti i zgjerimit termik	2.5 x 10 ⁻⁵ për °C (shkallë temperature: -20°C deri +40°C)			(EN 1770)	

Temperatura e tranzicionit të qelqit	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes	TG	(EN 12614)
	30 ditë	+30 °C	+52 °C	
Temperatura e shformimit termoplastik	Koha e tharjes	Temperatura e tharjes	HDT	(ASTM-D 648)
	3 orë	+80 °C	+53 °C	
	6 orë	+60 °C	+53 °C	
	7 ditë	+35 °C	+53 °C	
	7 ditë	+10 °C	+36 °C	
Temperatura e funksionimit	-40 °C deri në +45 °C (i tharë në +23 °C)			

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	Përbërësi A : Përbërësi B = 3 : 1 për peshë ose vëllim Kur përdorni material rifuxho, raporti i saktë i përzierjes duhet të ruhet nga peshimi dhe dozimi i saktë i secilit përbërës.			
Trashësia e shtresës	30 mm max.			
Rrjedha e varjes	Mbi sipërfaqet vertikale nuk varet deri në trashësi 3–5 mm në 35 °C	(FIP: Fédération Internationale de la Précontrainte)		
Aftësia e ngjeshjes	4'000 mm ² në +15 °C për 15 kg	(FIP: Fédération Internationale de la Précontrainte)		
Temperatura e produktit	Sikadur®-30 duhet të aplikohet në temperatura midis +8 °C dhe +35 °C.			
Temperatura e mjedisit	+8 °C min. / +35 °C max.			
Pika e vesës	Kujdes kondensimin. Temperatura e nënshtresës gjatë aplikimit duhet të jetë të paktën mbi 3°C mbi pikën e vesës.			
Temperatura e nënshtresës	+8 °C min. / +35 °C max.			
Lagështia e përmbajtur e nënshtresës	Max. 4 % pjesë për peshë Kua aplikohet mbi beton të lagësht mat, shtroni ngjitësin mirë me furçë mbi nënshtresë.			
Koha e punueshmërisë	Temperatura	Koha e punueshmërisë	Koha e punës	(FIP: Fédération Internationale de la Précontrainte)
	+8 °C	~120 minuta	~150 minuta	
	+20 °C	~90 minuta	~110 minuta	
	+35 °C	~20 minuta	~50 minuta	
Koha e punueshmërisë fillon kur rrëshira dhe forcuesi janë përzierë. Është e shkurtër në temperatura të larta dhe e gjatë në temperatura të ulëta. Sa më e madhe të jetë sasia e përzierë, aq më e shkurtër është koha e punueshmërisë. Për të përfutur punueshmëri më të gjatë në temperatura të larta, ngjitësi i përzierë mund të ndahet në pjesë. Një mënyrë tjetër është të ftohni përbërësit A+B përpara përzierjes (jo nën +5°C).				

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Shih skedën teknike të pllakave Sika® CarboDur® dhe shufrave Sika® CarboDur® BC.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Shih "Method Statement për Përforcimin me ngjitje të jashtme Sika® CarboDur®" Ref: 850 41 05 dhe "Method Statement për Përforcimin Sika® CarboDur® të montuar pranë sipërfaqes" Ref: 850 41 07.

PËRZIERJA

Njësi të parapaketuara:

Përziëni përbërësit A+B për të paktën 3 min. me një aks të lidhur në mikserin elektrik me shpejtësi të ulët (max. 300 rpm) derisa materiali të ketë konsistencë të lëmuar dhe ngjyrë gri të njëtrajtshme. Shmangni hyrjen e ajrit gjatë përzierjes. Pastaj, hidheni të gjithë përzierjen në një enë të pastër dhe përziëni sërish për ~ edhe 1 min. në shpejtësi të ulët që të minimizohet bllokimi i ajrit. Përziëni vetëm atë sasi që mund të përdoret brenda kohës së punës.

Ambalazh rifuxho, jo i paketuar:

Në fillim, përziëni plotësisht secilin përbërës. Shtoni përbërësit në raportet e duhura brenda një kove të përshtatshme dhe përziëni me një mikser në shpejtësi të ulët si më sipër.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Shih "Method Statement për Përfrocimin Sika® CarboDur® me ngjitje të jashtme" Ref: 850 41 05 dhe "Method Statement për Përfrocimin Sika® CarboDur® të montuar pranë sipërfaqes" Ref: 850 41 07.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni veglat dhe pajisjen e aplikimit me Sika® Colma Cleaner menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

Urshirat Sikadur® janë formuluar për të patur zvarrje të ulët në ngarkesë të përhershme. Megjithatë, për shkak të sjelljes së zvarrjes të të gjitha materialeve polimere nën ngarkesë, projektimi afatgjatë i ngarkesës së strukturës duhet të përllogarisë edhe zvarrjen. Në përgjithësi, projektimi afatgjatë i ngarkesës së strukturës duhet të jetë më i ulët se 20-25% e ngarkesës dështuese.

Ju lutemi, konsultohuni me një inxhinier strukturist për llogaritjet e ngarkesës të aplikimit specifik.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikadur®-30

Maj 2019, Botimi 03.01

020206040010000001

Sikadur-30-sq-AL-(05-2019)-3-1.pdf